VENDIM
Nr.51, datë 26.1.2011

PËR NJË SHTESË FONDI KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE TË KRIJUAR NË QARKUN E SHKODRËS, SI PASOJË E PËRMBYTJEVE NATYRORE

(Ndryshuar me VKM nr. 247, datë 31.3.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", si dhe të nenit 31 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit financiar prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, për përballimin e situatës emergjente të krijuar në qarkun e Shkodrës, si pasojë e përmbytjeve natyrore, të ndarë si më poshtë vijon:

a) 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekë për blerjen, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të bazës ushqimore (koncentrat e bar i thatë), për periudhën janar-mars 2011;

b) 25 029 876 (njëzet e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë për kryerjen e punimeve emergjente në disa objekte (argjinatura) për mbrojtjen nga përmbytja.

2. Fondi prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet si më poshtë:

a) 125 029 876 (njëqind e njëzet e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë nga KESH sh.a., për Ministrinë e Brendshme, në programin "Emergjenca civile";

b) Fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2.1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nga fondi i mbështetjes për bujqësinë, artikulli 606 "Transferta në buxhetet familjare", të kryejë rialokimin në artikullin buxhetor 602 të shumës prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, e cila të përdoret nga aparati i ministrisë, për përfundimin e pagesave të detyrimeve, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha